



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

ODËS SË NDËRMJETËSUESVE TË KOSOVËS

dhe

UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA " PEJË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është krijimi i kushteve për bashkëpunim në mes të Universitetit “Haxhi Zeka”, në Pejë (tani e tutje referuar si UHZ), dhe Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës, (tani e tutje referuar si ONDK) për mundësinë e mbajtjes së praktikës dhe vizitave studimore për studentët e Universitetit “Haxhi Zeka” në Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës (ONDK) dhe prezantimi i ndërmjetësuesve para studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për trajnime e tema të veçanta që ndërlidhën me fushën e ndërmjetësimi.

Neni 2

Obligimet e Universitetit

2.1 UHZ siguron se puna praktike dhe vizitat studimore të studentëve në ONDK të vlerësohet dhe konsiderohet si pjesë shtesë e mësimi teorik dhe praktik të studentëve të këtij Fakulteti.

2.2 Në bashkëpunim me ONDK bënë përzgjedhjen e studentëve të cilët do të kryejnë vizitën studimore dhe punën praktike si dhe afatin e zgjatjes së punës praktike.

2.3 Njofton me kohë ONDK se kur mund të dërgohen studentët për vizita dhe punë praktike në ONDK.

2.4 Përgaditë dhe mirëmbanë regjistrin me emrat e studentëve dhe kohën në të cilën ata do të kryejnë vizitën dhe praktikën në ONDK, si dhe ia dërgon ONDK listën e studentëve vizitorë dhe praktikantëve së paku një javë para fillimit të mbajtjes së vizites apo praktikës.

Neni 3

Obligimet e ONDK

3.1 Në koordinim me UHZ u mundëson studentëve të këtij Fakulteti realizimin e vizitave studimore dhe mbajtjen e punës praktike për periudhën kohore të përcaktuar nga ONDK në koordinim me Fakultetin Juridik i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

3.2. Njofton UHZ-në me kohë, për numrin e studentëve që mund të kryejnë vizita studimore dhe punë praktike sipas kritereve të caktuara.

3.3. Njofton UHZ-në për kohën dhe vendin e mbajtjes së vizitës së studentëve dhe praktikës së studentëve.

Neni 4

Bashkëpunimi profesional

4.1 Palët pajtohen të organizojnë aktivitete të përbashkëta profesionale (ligjerata/debate) me qëllim të shkëmbimit të praktikave në drejtim të rritjes së cilësisë së studimit për studentët.

4.2 Për implementimin e konferencave / debateve / simpoziumeve, UHZ i vë në dispozicion të ONDK pa kompensim klasat dhe ambientet e tjera;

4.3 Kufizim i vetëm për mos implementimin e paragrafit 4.1 dhe 4.2, është nëse këto organizime do të pengonin mbarëvajtjen e procesit të rregullt mësimor, orarit të ligjeratave dhe provimeve të studentëve të Fakultetit Juridik i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Neni 5 **Konfidencialiteti**

Palët do të ruajnë konfidencialitetin e njëra-tjetrës, për të cilat do të vendosen në dijeni si rrjedhojë e bashkëpunimit të ndërsjellë të palëve.

Neni 6 **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

5.1 Marrëveshja nënshkruhet për periudhën 3 (tre) vjeçare, me mundësi vazhdimi.

5.2 Në rast se asnjëra nga palët nënshkruese nuk e paralajmëron shkëputjen e kësaj marrëveshje, një muaj para përfundimit të saj, i njëjta konsiderohet së është vazhduar edhe për një vit kalendarik.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**


Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Universitetit “Haxhi Zeka”
në Pejë

Oda e Ndërmjetësuesve të
Kosovës

Prof. Dr. Armand Krasniqi
Rektor

Ganimete Xhelili
Kryetare e ONDK



Data: ____ . ____ . ____